

---

**DOKUMENTE E MATERIALE**

---

**ANA LALAJ****1953 - UDHËHEQËSIT E RINJ SOVJETIKË PARALAJMËROJNË:  
OSE NDRYSHIME OSE KATASTROFË**

Më 5 mars 1953, Stalini vdiq, kurse në ditën e funeralit të Stalinit, më 9 mars 1953, mijëra shqiptarë, bashkë me Enver Hoxhën, ranë në gjuhë përpara përmendores së bronzit në qendër të Tiranës. Që prej asaj dite, 730 mijë njerëz, në një popullsi më pak se 1.3 milionëshe, vunë firmat në “Betimin e popullit shqiptar para Stalinit të Madh” dhe më 2 korrik ai iu përcoll Moskës.<sup>1</sup> Procesione të ngjashme u mbajtën edhe në kryeqytetet e tjera komuniste. Por shpejt u pa se këto betime “popullore” besnikërie ishin vetëm fasada. Burime të ndryshme, sidomos ato diplomatike, bënë fjalë se në vendet e Bllokut ishte fermentuar një gjendje shpërthyes, për shkak të vështirësive ekonomike, por edhe për shkak të drejtimit të keq dhe represionit që drejtuesit komunistë të këtyre vendeve ushtronin në popull. Në qershor të vitit 1953, ata thirrën me urgjencë në Moskë drejtuesit kryesorë të Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë, të Partisë së Popullit Punëtor Hungarez, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në vjeshtë të po atij viti udhëheqësit komunistë rumunë, çekë dhe polakë, të cilëve u bënë me dije se “pritej një katastrofë, nëse nuk do të merreshin masa”<sup>2</sup>. Për kryeministrin e ri sovjetik, Georgij Malenkov, situata në kampin komunist ishte e vështirë dhe delikate. Një paketë ndërhyrjesh të ngutshme u mendua si rruga më e përshtatshme për të shmangur trazirat, që mund të ktheheshin në rrezik edhe për vetë kampin, që deri atëherë ishte mbajtur kompakt falë liderit të tij të vdekur. Veç specifikave të çdo vendi, paketa shënonte si përparësore përmbushjen e nevojave të popullsisë me produkte ushqimore dhe mallra konsumi, politika më liberale tregu dhe shërbimesh për qytetarët, administratë më pak e kushtueshme, kufizim i dhunës politike, përmirësim i marrëdhënieve me fqinjët etj. E veçanta është se kjo

---

<sup>1</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi: Arkivi i Partisë (më tej: AP) / Marrëdhëniet e PPSH-BS (më tej: MPKBS), viti 1953, dos. 2. Shih edhe: *Zëri i popullit*, organ i KQ të PPSH, nr. 1385, 10 mars 1953.

<sup>2</sup> Christian Ostermann, “The United States, the East German Uprising of 1953, and the Limits of Rollback”, Working paper, no. 11, në: *Cold War International History Project*, Washington DC, December, 1994, f.7; Janos Rainer, “The New Course in Hungary in 1953”, Working Paper, no. 38, në: *Cold War International History Project*, Washington DC, June 2002, f. 16.

paketë masash, e nisur si paketë emergjece, u komentua si *kurs i ri* politik i Bllokut të Lindjes. Ky term u përdor së pari në komunikatën e publikuar pas takimit që udhëheqësit gjermanolindorë Walter Ulbricht dhe Oto Grotewohl kishin pasur në Moskë, më 2 deri më 4 qershor.<sup>3</sup> Me kohë, termi u përdor edhe nga të tjerë, politikanë dhe studiues, ashtu siç u zgjerua edhe përmbajtja fillestare e paketës.

Në qershor 1953, në Moskë u thirr edhe Enver Hoxha, atë kohë kryeministër i Shqipërisë. Autorja e këtij punimi ka në dorë vetëm shënimet që Hoxha ka mbajtur në Kremlin dhe raportin verbal që ai ka dhënë në Byronë Politike të KQ të PPSH, pas kthimit të tij nga Moska, më 20 dhe 22 qershor. Shënimet nuk përmbajnë as datën ose datat ekzakte kur Hoxha ka raportuar në Moskë, si dhe as personat që atë e kanë shoqëruar. Me siguri, në arkivat ruse procesverbalet janë të plota. Megjithatë edhe burimet shqiptare janë të mjaftueshme për të sqaruar këtë çast të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike.

Sipas shënimeve, Hoxha është thirrur nga kryeministri Georgij Malenkov, në prani të zëvendësve të tij, njëherësh ministra kryesorë të kabinetit, Lavrenti Beria, Vaçeslav Molotov, Nikolai Bulganin dhe Anastas Mikojan. Mungonte vetëm Lazar Kaganoviç. Kryeministri shqiptar është përprjekur t'i informojë drejtuesit e lartë sovjetikë për arritjet e deriatëhershme në Shqipëri, për “vështirësitë e rrethimit kapitalist”, por fjala e tij është ndërprerë, duke iu kërkuar atij nëse mund të njihej më parë me të dhënat që kishin sovjetikët dhe pastaj të diskutohej mbi to. Kanë folur të gjithë me radhë, por tonin e kritikave duket se e ka dhënë Beria. Udhëheqësit sovjetikë vunë theksin në vështirësitë ekonomike në Shqipëri, sidomos te fshatarësia që “nuk siguronte dot bukën e gojës”; te administratën e fryrë, sa as Rokfeleri e Morgani nuk do të guxonin ta mbanin”; te çmimet e larta të konsumit të gjerë; dhe urdhëruan që “disa shokë drejtues duhet të shkarkohen nga përgjegjësitë e tepërta.”

Hoxha i pranoi kritikën, duke i cilësuar ato si “bolshevike” dhe ndihmë e madhe për partinë dhe vendin e tij. Në një takim të dytë është folur konkretisht për disa masa të menjëhershme, midis tyre përgjysmimin e kabinetit qeveritar. Hoxha ka bërë të njohur edhe projektin me emrat e rinj të ministrave. Po kështu sovjetikët kanë premtuar të çojnë 250 oficerë në ndihmë të ushtrisë shqiptare, por Hoxha ka kërkuar edhe 38 të tjerë për forcat e Ministrisë së Brendshme, si dhe disa këshilltarë për ekonominë.

Kritikat sovjetike E. Hoxha ia transmetoi Byrosë Politike më 20 dhe 22 qershor 1953. Aty u vendos të studiohej gjendja dhe të bëheshin propozime në tri fusha. E para ishte përmirësimi i ekonomisë e sidomos gjendja e fshatit. E dyta ishte reforma në ushtri dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. E treta, përmirësimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, sidomos me fqinjët. Bie në sy që Hoxha ka qenë i shqetësuar për reformat në aparatet shtetërore, në administratë dhe në ushtri, prandaj ka orientuar që gjithçka të mbahej në sekret të plotë dhe

<sup>3</sup> Ch. Ostermann, *art. i cit.*, f. 7; J. Rainer, *art. i cit.*, f. 13.

në grupet e punës bashkëpunëtorët të porositeshin “*se për çdo fjalë të dalë prej tyre do të ketë menjëherë pushkatim*”.<sup>4</sup> Ky mesazh i pazakontë dhe hapur kërcënues është motivuar me kujdesin për të mos u krijuar ankth dhe panik tek njerëzit për humbjen e vendeve të punës, megjithatë kjo nuk duhet të ketë qenë arsyeja e vetme. Një arsye kryesore pse Hoxha ndjehej i acaruar shpjegohet me faktin se vetë qeveria sovjetike ishte vënë në alarm për zhvillimet e ardhshme brenda Bllokut. Ashtu si edhe drejtuesve të tjerë të Lindjes, shqiptarëve u ishte theksuar fort se duheshin përmirësime të shpejta në vend, “përndryshe do të ndodhte katastrofa”.<sup>5</sup> Por ajo që e alarmonte më shumë Hoxhën duket se ishin ndryshimet e raporteve të tij me Moskën. Që prej vitit 1948 ai kishte marrë mbështetjen e Stalinit, duke i forcuar mjaft pozitat. Tani ato ishin të lëkundura. Për më tepër, dy prej bashkëpunëtorëve të tij më të afërt, Mehmet Shehu dhe Hysni Kapo, i kishin kërkuar që, me këtë rast, të hapej një analizë në parti rreth “përgjegjësive kolektive”. Natyrisht kjo e trembte Hoxhën dhe ia doli ta shmangë. Arsyeja e fundit duhet të ketë lidhje me ngjarjet në Gjermaninë Lindore. Ndërsa diskutohej në Tiranë, po bëhej java që një milion gjermanolindorë ishin përfshirë në protesta, të cilat u shuan me mbështetjen e trupave ushtarake sovjetike. Në protesta u vranë 50 vetë dhe më pas hynë në burgje disa mijëra. Megjithëse këto ngjarje nuk u zunë në gojë, Hoxha duhet të ketë pasur informacione rreth tyre, që risillnin në vëmendje edhe paralajmërimet për “katastrofë”.

Këto bisedime nuk janë përfshirë në veprat seriale të Enver Hoxhës. Për to flitet vetëm në librin e tij me kujtime: *Hrushovianët*. Por në atë libër këto bisedime janë paraqitur të deformatuara, sikur Enver Hoxha kishte shkuar me iniciativën e tij në Moskë për të dhe në kundërshtim të plotë me dokumentin arkivor, të cilin po e publikojmë në këtë numër të revistës *Studime Historike*.

\*\*\*\*\*

**AQSH, AP/OU, V. 1953, D. 23**

**PROTOKOLL Nr. 17**

**më 20 qershor 1953, i mbledhjes Byrosë Politike të KQ PPSH**

**Rendi i ditës:**

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të PPSH, shokut Enver Hoxha, mbas kthimit të tij nga Moska, ku pati takim me udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe të qeverisë së Bashkimit sovjetik në gjysmën e parë të muajit qershor të këtij viti.

<sup>4</sup> *AQSh*, AP/OU, viti 1953, dos. 23, f. 32.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 26.

Në këtë mbledhje, përveç shokëve të zakonshëm mungon shoku Rita Marko, i cili ndodhet me pushime në Korçë.

### **Zhvillimi i Mbledhjes:**

Mbledhjen e hapi Sekretari i Përgjithshëm i PPSH, shoku Enver Hoxha, i cili filloi menjëherë të japë raportin verbal mbi çështjen që përmend rendi i ditës:

#### *Shoku Enver Hoxha:*

Siç e dini, me kërkesën e shokëve udhëheqës sovjetikë shkova në Moskë për të biseduar në lidhje me situatën politike, ekonomike, ushtrinë etj. Atje na pritën shokët Malenkov, Beria, Molotov, Bulganin dhe Mikojan. Porsa hapën mbledhjen na thanë se para se të fillojmë dëshirojmë të bëjmë një pasqyrë të situatës sonë apo doni të flisni ju përpara. Ata thanë të themi ne ato që kemi ne, t'u bëjmë edhe propozimet që mendojmë ne, pastaj të diskutojmë. Unë u thashë se më e mira do të ishte të flisja unë përpara, dhe si e aprovuan propozimin tim fillova të flisja unë mbi situatën e brendshme të vendit tonë. Fola kështu nja 10-15 minuta duke vënë në dukje se me gjithë vështirësitë e rrethimit kapitalist, me gjithë provokacionet e vazhdueshme të armiqve dhe gjendjen ekonomike të pakënaqshme të popullit tonë, gjendja nuk është aq e keqe. Megjithëkëtë, vazhdova unë, armiku na lufton dhe ka baza në vendin tonë të cilat ua thashë me radhë. U thashë se armiku në vendin tonë mbështetet në radhë të parë në reaksionin e brendshëm, por edhe në emigracionin shqiptar, në minoritetin etj. Kundra bandave, diversantëve dhe parashutistëve kemi pasur suksese dhe i kemi likuiduar. Tani armiku na lufton me të gjitha forcat me anën ekonomike, të cilën e kemi të dobët. Edhe sot kemi në shumë sektorë mjaft vjedhje, ngadalësime në realizimin e planit etj.

Këtu Malenkovi ma ndërpreu fjalën dhe më tha se sikur ju shoku Enver na e paraqitni situatën e brendshme të Shqipërisë si të kënaqshme, kurse ne kemi të dhëna që nuk është ashtu. Prandaj mendoj se është më mirë tua themi ne konstatimet tona, pastaj diskutoni dhe ju mbi çështjet që do të shtrojmë ne. Natyrisht ne nuk mendojmë të piqemi një herë vetëm, mund të mblidhemi përsëri e po të jetë nevoja akoma edhe dy herë të tjera për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Unë i thashë se isha dakord me këtë propozim.

Pastaj Malenkovi ia dha fjalën Berias, i cili tha se situata në Shq na u paraqit e kënaqshme por ne mendojmë se nuk është ashtu. Ne do të shfaqim pikëpamjen tonë për disa çështje si dhe propozimet që kemi menduar. Armiqtë tuaj nuk mbështeten në kontingjentet që thatë ju por në elementët armiq që i keni Brenda në pushtet, në ushtri ku mund të keni 30-35% të oficerëve armiq. Pastaj edhe në aparatet e partisë ju keni njerëz të dyshimtë. Mbështetje e mirë për punën e armikut të jashtëm është edhe fshatarësia tuaj. Këto gjëra na lejojnë të themi se situata juaj nuk është e kënaqshme, se fshatarët tuaj janë shumë të pakënaqur pasi ju ata i keni mbytur dhe i shfrytëzoni në palcë. Këto fjalë Beria

mi drejtoi copë. Ju e vidhni, e grabitni fshatarësinë (nënvizimi im- A.L.). Aparatet e shtetit tuaj janë kolosale dhe tregoi shifra që janë me të vërtetë skandaloze. Beria tha se as Rokfeleri, as Morgani nuk do të guxonin të mbanin një aparat kaq të madh i cili ha në kurrizin e fshatarësisë. Natyrisht kjo barrë e rëndë krijon një pakënaqësi të madhe për fshatarët, pakënaqësi që tani mund të jetë e heshtur por më vonë mund edhe të shpërthejë. Pra, në ato pakënaqësi mbështetet armiku i jashtëm. Kështu që ju në rast se nuk e ndryshoni gjendjen e fshatarësisë do t'u ndodhin skandale të mëdha. Në aparatin tuaj të shtetit ka vjedhje, sabotazhe të bëra nga njerëz të fshehur që edhe ata janë mbështetje e armikut, bazë të spiunazhit të huaj. Ju e dini se në Jugosllavi janë krijuar reparte me reaksionarë shqiptarë, të cilëve amerikanët ndonjëherë do t'u japin urdhër t'u sulmojnë, ndoshta jo nesër, por ata përgatiten në këtë drejtim. Prandaj tha Beria, ne propozojmë që ta studiojmë këtë çështje dhe të merrni masa për ta likuiduar këtë situatë dhe në radhë të parë të shkurtoni aparatet shtetërore. Po të bëni këtë, atëherë do të shkurtoni vjedhjet, sabotazhet, dhe ekonomia juaj do të lulëzojë e fshatarësia do të marrë veten. Ne kemi informacion se fshatarësia juaj jeton në mënyrë mizarabël, nuk kanë qe, parmenda, vezë, derra. Ata kanë gati 10 vjet që janë çliruar dhe jetojnë shumë keq, Si mundet pra fshatari ta durojë një gjendje të tillë? Të gjitha këto gjëra që keni bërë ju e kanë bërë fshatarësinë të pakënaqur. Edhe bagëtittë nuk ia lini fshatarësisë t'i rriten, sepse me të filluar të mëkëmbë ai ekonominë, ju menjëherë nxirrni ligje dhe urdhëresa dhe ja rrëmbeni. Le të kenë fshatarët tuaj nga 100 kokë dele që të hanë qumësht dhe mish, fshatarët janë populli, ju jeni një vend malësor, prandaj duhet të keni të zhvilluar blegtorinë. Për këtë me të gjitha forcat duhet të ndihmoni fshatarësinë që të zhvillojë ekonominë e saj dhe të ketë të hajë e të pijë mirë, ndryshe nuk ka se si ta keni me vete. Prandaj meqenëse fshatarësia është në një situatë të tillë, klasa punëtore është në një gjendje akoma më të mjeruar. Ju keni inflacion dhe punëtorët nuk blejnë dot sendet më të nevojshme për jetesë me pagat që marrin, prandaj duhet të merrni masa sa më të shpejta për të përmirësuar gjendjen se do t'u ngjasin skandale. Edhe në aparatet e Partisë keni njerëz të dyshimtë dhe aparatet në përgjithësi i keni të fryrë, prandaj ju duhet të merrni masa për t'i shkurtuar sa më parë këto aparate. Ju mbani 18 ministri, ç'u duhen gjithë këto, për ju mjaftojnë vetëm 3 ose 4. Zhdrukini të gjitha drejtoritë që keni krijuar; veproni si kemi vepruar në kohët e fundit, bëni sa më shumë shkurtime në aparatet.

Pastaj e mori fjalën Molotovi, i cili tha se pa dyshim gjendja te ju është ashtu si e tha shoku Beria, prandaj detyra e parë është të forconi gjendjen e brendshme të vendit. Por edhe situata e jashtme ka rëndësi shumë të madhe për Shqipërinë si vend i vogël që është dhe i rrethuar nga të katër anët me armiq. Domethënë duhet t'i vini rëndësi edhe situatës së jashtme dhe të merrni masa në këtë drejtim. Gjer tani mund të them se çdo veprim është bërë në drejtimin që të ashpërsohet sa më shumë situata me fqinjët. Unë e di se ju në çdo hap në

politikën tuaj të jashtme keni vepruar në këshillim me ne. Por këtej e tutje edhe ju edhe ne duhet të revizionojmë qëndrimin tonë të jashtëm.

Këtu ndërhyri Malenkovi dhe tha se këtë qëndrim të ashpër që keni mbajtur ju me shtetet fqinje e keni bërë se nuk donit të veni në kundërshtim me politikën e qeverisë sovjetike.

Jo, i thashë unë, por ne jemi një vend i vogël dhe nuk pretendojmë të bëjmë një politikë independente. Pa bashkëpunuar ngushtë me BS ne nuk mund të ecim dot përpara.

Molotovi tha pastaj se marrëdhëniet tuaja me fqinjët domethënë me Greqinë, Jugosllavinë dhe Italinë duhet të përmirësohen, prandaj duhet punuar në këtë drejtim. Por edhe ne nga ana jonë u kemi ndihmuar pak. Tani si ne ashtu dhe vendet e demokracisë popullore do të punojmë për t'u krijuar mundësira më të mëdha për këtë.

Pas Molotovit foli Bulganini. Tek ju shokë shqiptarë është krijuar pikëpamja se ushtrinë e keni qindpërqind me vete. Kjo nuk është e vërtetë, pasi 35% e oficerëve tuaj janë me armikun, gjë që tregon se ju nuk e njihni situatën e ushtrisë. Në Komitetin Qendror ju keni një Komision për spastrimin e Ushtrisë të cilit i është dhënë një afat prej një viti për ta kryer punën. Ky është një afat shumë i gjatë. Ç'bën ky Komision kaq ngadalë? Pastaj vetë Ministri i Mbrojtjes, meqenëse është i zënë me shumë punë nuk është interesuar efektivisht për këtë sektor të rëndësishëm, dhe meqenëse ju jeni Ministri i Mbrojtjes, më lejoni tu them se puna juaj nuk ka qenë e kënaqshme. Ju duhet ta keni të pastër ushtrinë që të bëhet tuaja qindpërqind, tha ai. Prandaj pastrimi duhet bërë sa më shpejt, ta forconi sa më shumë gjendjen në ushtri dhe ne jemi gati t'u ndihmojmë në këtë drejtim. Ne u japim edhe 250 oficerë, tha Beria, por ata që ju janë dërguar deri tani i keni si këshilltarë, domethënë bëjnë një punë pasive. Ne mendojmë që oficerët sovjetikë të mos jenë më këshilltarë, por ndihmës komandantë që të mund të japin një ndihmë më konkrete dhe të drejtpërdrejtë.

Pastaj e mori fjalën Mikoiani, i cili foli për çështjet ekonomike. Ai tregoi se situata jonë ekonomike me jashtë është jashtëzakonisht e keqe. Për ta ilustruar këtë dha edhe shifra, përqindje. Më parë ai foli për bujqësinë dhe vuri në dukje se ju keni kaq mijëra ekonomi pa kafshë pune; 25% bagëti më pak se para lufte dhe çdo vit numri i bagëtive ulet. Ju importoni bukë me dhjetëra mijë tonelata në vit. Ju keni nevojë për kafshë, por dhe ato që keni nuk i ushqeni, nuk i shtoni. Nga ana tjetër keni pak traktorë, dhe nuk keni krijuar kondita të favorshme për kolektivizimin. Ju fshatarët i shfrytëzoni dhe kjo bën që edhe punëtorët të vuajnë, nuk keni krijuar kondita të favorshme për punëtorët në qendrat e punës. Rrogat e punëtorëve të naftës në vend që të jenë më të larta janë njësoj me ato të punëtorëve të industrisë ushqimore. Prandaj një situatë e tillë është e padurueshme për popullin shqiptar. Pastaj ju bëni ndërtime kolosale dhe kjo u nxjerr nevojën e madhe të krahut të punës.

Gjithë këto ndërtime që bëni ju, le që nuk po i realizoni dot por në ato që jeni duke bërë shkaktoni që të thithet nga fshati krahu i punës i nevojshëm për bujqësinë. Pastaj edhe fshatarët nuk vinë të bëhen punëtorë se kushtet e punës në qendrat e punës janë shumë të këqija dhe punëtorët vuajnë. Në këtë situatë që është te ju kolektivizimi ecën ngadalë, pa plan, nuk ka organizim të mirë në këtë drejtim, nuk merrni masa të forconi ato kooperativa që keni. Edhe traktorë keni pak, prandaj konditat nuk janë të mira, se fshatarësia nuk shikon akoma interes të futet në to. Nuk është akoma e bindur për kolektivizimin se nuk i janë krijuar konditat. Pastaj foli për qetë që në vendin tonë janë shumë të paktë dhe ju nuk bëni përpjekje për t'iu shtuar, tha ai. Numri i qeve në Shqipëri është në shpërpjestim të madh në krahasim me sipërfaqen e tokave të mbjella dhe kjo përbën një situatë katastrofike për bujqësinë.

Çështjet financiare te ju shkojnë shumë keq, keni inflacion, keni shtuar qarkullimin e monedhës 40% ndërsa xhiron e tregtisë vetëm 26%. Ju nuk dini të bëni tregti, impononi në treg çmime të larta, mbyllni dyqane, keni krijuar tregun e zi dhe merrni masa të dëmshme administrative për çmimet në tregti. Privati nuk ka leverdi të tregtojë me masat që keni marrë ju dhe ata të paktë që kanë mbetur zhvillojnë tregun e zi.

Planet tuaja vazhdimisht nuk po realizohen. Në ndërtim ju mungon krahu i punës sepse nuk keni krijuar kondita të mira për punëtorët. Pastaj jeni angazhuar në ndërtime të mëdha, në ngritje fabrikash që tash për tash nuk janë aq të nevojshme për ekonominë tuaj. Gjithçka sa keni bërë deri tani i keni bërë pa llogari, jo në bazë të konditave reale të vendit tuaj. Ju ndërtoni hidrocentrale mbi Mat ndërsa ne po vrasim mendjen për të mësuar se ç'u duhet gjithë kjo vepër, ku do ta përdorni gjithë këtë energji gjersa të gjithë fabrikat tuaja të reja që janë ndërtuar deri tani kanë TEC-et e tyre kështu që e kanë të mjaftueshme energjinë. Pastaj ky hidrocentral ju kushton jashtëzakonisht shumë. Keni vënë në plan të ndërtoni një varg fabrikash të panevojshme si ato të çelikut, letrës, qelqit etj, keni ngarkuar popullin me ndërtime kolosale. Prandaj në një situatë të tillë nuk mund të ecë mirë ekonomia e vendit tuaj. Në rast se hiqni disa nga këto ndërtime ju do të përmirësoni situatën, do t'u jepet mundësi të përfundoni shpejt fabrikat e tjera dhe ato të punojnë me rendimentin e caktuar, se rendimentet tuaja janë kudo të ulëta. Përse e bëni gjithë këtë rafineri të madhe?

Këtu ndërhyri Malenkovi dhe tha se kjo Rafineri që bëni a do të punojë dot vazhdimisht dhe me rendiment të plotë, a keni naftë të mjaftueshme për ta ushqyer, apo do të punojë me rendiment të ulët? Edhe Beria këtë pyetje vuri. Ç'u duhet ju gjithë ajo rafineri, tha Mikoiani. Prandaj rishikojeni këtë çështje tha, dhe nuk u zgjat më tej. Pse shkoni drejt e në gjëra të mëdha? Pse nuk bëni oleodotin nga Patosi në qytetin Stalin, pse nuk zgjeroni rafineritë që keni, ato do t'u kushtojnë më pak. Më vonë, kur të jeni më në gjendje dhe të keni prodhim të mjaftueshëm bëni edhe ndonjë rafineri të madhe. Prandaj jo drejt e në të mëdhatë. Nga i gjithë ky orientim jo i drejtë dhe bujqësia tuaj është në një

gjendje shumë kritike, prandaj duhet të merrni masat që të përmirësohet. Detyrimet karshi fshatarëve i keni shumë të larta. I lehtësoni malësitë nga këto detyrime dhe i jepni mundësi popullit të ketë bukë, të vejë bagëti, të ketë pula, vezë, të shtojë ushqimin për kafshët. Kështu nuk mund të ecet dhe kjo është një situatë shumë e rëndë që është krijuar te ju, prandaj lereni fshatarin të marrë frymë.

Më në fund Malenkovi bëri një përmbledhje të atyre që thanë shokët e tjerë. Ai theksoi edhe një herë se gjendja e brendshme e vendit tuaj nuk është e kënaqshme. Në drejtim të fshatarësisë ju keni bërë gabime, dhe në aparatet e shtetit, të partisë e të ushtrisë keni njerëz të dyshimtë. Prandaj këto të dhëna që disponojmë na kanë alarmuar dhe për këtë u thirrëm që të marrim së bashku masa konkrete për ta përmirësuar gjendjen

Pasta ja vuri si detyrë të parë shkurtimin e aparateve shtetërore. Këshilli ministror tuaji, tha ai, nuk bën gjë tjetër veçse firmos dhe vulos vendimet e Byrosë Politike dhe po të mos bëjë asgjë Byroja Politike, Këshilli i Ministrave nuk bën asgjë në vend që të punojë në bazë të vijës që është caktuar. Mendojmë që ju dhe Mehmeti dhe disa shokë të tjerë keni shumë përgjegjësi. Kjo mund të ishte e mirë përpara, por tani është e dëmshme. P.sh. ti, më tha mua, je kryeministër, sekretar i përgjithshëm i partisë, ministër i mbrojtjes, ministër i punëve të jashtme, kryetar i Frontit demokratik etj. Prandaj shkarkohuni nga disa prej këtyre detyrave dhe ngarkoni shokë të tjerë të rinj që të marrin edhe ata përgjegjësitë që puna të eci përpara. I ndihmoni shokët e rinj dhe do të shikoni se do të punojnë. Këto janë çështjet që mendojmë ne që i konsiderojmë se kanë shumë rëndësi, nuk janë të vogla, prandaj dhe nuk mund t'i zgjidhni shpejt.

Kështu që në rast se jeni dakord jemi gati të bisedojmë edhe një herë, bile edhe dy herë të tjera po të jetë nevoja. Mendohuni cila është pikëpamja juaj, propozimet tuaja, por konkretisht dhe emër për emër, që të mundim t'u ndihmojmë për të gjitha çështjet. Nuk është e nevojshme që çështjet t'i përgatisni me shkrim, por me shënime se na kalon shumë kohë.

Beria tha se këtu mjafton të mbetemi dakord për çështjet kryesore, dhe kur të venë në Shqipëri, Komiteti Qendror, qeveria, dhe Byroja Politike do të bëjnë ligje, urdhëresa, vendime për të venë në jetë këto ndryshime.

Beria tha mendoni dhe për çështjen e ushtrisë, për forcimin e kufirit. T'i bëni repartet e ushtrisë dhe të kufirit të lehta, më operative, më të përqendruara, në dy tre vende, që në rast rreziku t'i keni grusht dhe jo të shpërndara. Mua m'u duk se këtë këshillë na e bënë vetëm për kufirin, por më vonë e theksoi edhe njëherë se vlen edhe për ushtrinë. Beria tha se kufiri nuk është nevoja të bëhet gardh siç ndodh në ditët festive, sikur do të na sulmojnë, por atje duhet të ketë forca të ndjekjes. I keni shumë të rënda repartet e ushtrisë. Vendi juaj është malor, prandaj repartet duhet të jenë të lehta, tipe brigadash, prandaj e studioni mirë këtë çështje.

Këtu mbaroi mbledhja e parë, ne shkuam të punonim me shokët. Ata më porositën të veja vetëm, por kur u nisa për të shkuar vetëm herën e dytë më

lajmëruan t'i merrja edhe ata, kështu shkuam të tre bashkë. Në fund të mbledhjes së parë përgjigja ime ishte: Ne ju falënderojmë, ju thashë unë, për interesimin dhe ndihmën e madhe që na keni dhënë dhe po na jepni. Ne i gjejmë plotësisht të drejta vërejtjet tuaja mbi punën tonë në përgjithësi, kritikën që më bëni mua personalisht dhe këshillat për përmirësimin e gjendjes, për forcimin e gjendjes së brendshme, të ushtrisë dhe politikës së jashtme, i aprovojme plotësisht dhe këtë e konsiderojmë një ndihmë shumë të madhe dhe të çmueshme. Ne do të venë të gjithë forcat për përmirësimin e gjendjes së pop tonë. Jam plotësisht dakord edhe për kritikën bolshevike që më bëtë mua dhe këtë e tutje unë do të interesohem më shumë për ushtrinë. I gjej të drejta këto kritika dhe patjetër ato do të na ndihmojnë shumë. Unë jam i mendimit se unë dhe disa shokë të tjerë që jemi ngarkuar me shumë përgjegjësi të shkarkohemi nga një pjesë e tyre.

Për veten time mendoj të shkarkohem nga përgjegjësia e Ministrit të jashtëm, e ministrit të mbrojtjes dhe nga Kryesia e Frontit Demokratik. Në Shqipëri do të mendojmë dhe për shokët e tjerë. Unë mendoj se duhet të ngarkojmë edhe një shok sekretar për drejtimin e punëve të partisë që të jetë në krye dhe përgjegjës për këtë punë.

Mendimi tim është se shoku Mehmet Shehu e bën shumë mirë këtë, por duke marrë parasysh rëndësinë që ka Ministria e Punëve të Brendshme në situatën tonë, mendoj që Mehmeti të mos hiqej andej, pse është i domosdoshëm të rrijë atje. Të gjitha këto veprime të mijat ata i aprovuan pa përjashtim.

Pastaj unë u hodha në shkurtimin e aparateve, kisha vënë edhe emra, por Beria u hodh e tha se këto gjëra i shikoni vetë atje. Unë i thashë se i shtroj një herë këtu për t'u këshilluar. Mirë thanë, atëherë mund t'u ndihmojmë.

Ne arritëm në konkluzionin se nga 18 ministri të ketë vetëm 9, nga të cilat industri, miniera dhe ndërtim të organizohen në një dikaster dhe të drejtohen nga Spiro Koleka, ai e njeht mirë sektorin e ndërtimit. Drejtë e ke tha Beria. Pastaj bujqësi, pyje e grumbullim të jetë Hysni Kapo. Tregtinë e brendshme, të jashtme dhe komunikacionin t'i ketë Gogo Nushi, kurse organizatat shoqërore, si kooperativat tregtare dhe të artizanatit nuk kemi si t'i shkrijmë se ato janë aparate të veçanta. Arsimi, kultura, fizkultura dhe shëndetësia të organizohen në një dikaster nën drejtimin e Bedri Spahiut. Ministër i brendshëm të jetë Mehmeti [Shehu], ministër i mbrojtjes të jetë Beqiri [Balluku], i financave të jetë Tuku [Jakova], i drejtësisë të jetë Bilbil Klosi, Kryetar i komisionit të Planit të jetë Koço Theodhosi dhe Kryetar i Komisionit të Kontrollit Maqo Çomo. Ministrinë e jashtme e lashë bosh. Përsa i përket çështjes së Bilbil Klosit dhe të Maqo Çomos mund ta shohim përsëri. Pastaj u thashë së është mirë të ketë një ose dy zv/kryeministra. Ata thanë se më mirë është të jenë dy. Nënkyeministër i parë thashë të jetë Mehmeti dhe i dytë të jetë Kapo. Ne mendojmë të suprimohet Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe

qeveria të mblidhet më shpesh. Këto propozime ata i aprovuan. Unë u thashë se do të marrim masa që t'i ngushtojmë aparatet në çdo sektor deri në 50%.

Pravilno, tha Beria.

*Shoku Mehmet Shehu:* Ne do të përpiqemi që të ecim edhe më thellë në shkurtime.

*Shoku Enver Hoxha:* Në lidhje me thjeshtimin e aparateve u thashë se do të bëjmë fuqizimin e drejtorive qendrore dhe ndërmarrjeve hozrashot, do të shkurtojmë aparatet e komiteteve ekzekutive të rretheve e lokaliteteve, do të studiojmë dhe riorganizojmë unitetin në drejtim të krijimit të 10 qarqeve, të suprimimit të lokaliteteve e shtimit më të madh të rretheve. Puna e shkurtimeve të aparateve u thashë se është një gjithë shumë e madhe, Për këtë qëllim u kërkova të na jepnin nja dy shokë me eksperiencë. Beria më tha se bëjeni vetë. Dhe kur u thashë se kjo është një punë e madhe, prapë tha, bëjeni vetë; për këto gjëra nuk u japim asnjë njeri.

Investimet që mund të ulim u thashë janë fabrika e letrës, e xhamit, e çelikut, e bukës, këto kemi menduar për të hequr; pastaj ndërtimin e disa të tjerave po të jemi dakord do t'i shtyjmë në pesëvjeçarin tjetër. Për fabrikën e librit u thashë se mendoj të mos e heqim nga plani, sepse me të do të fabrikojmë litar dhe spango, dy nga artikujt kryesorë për fshatarësinë tonë dhe këto nuk i gjejmë dot as në tregjet e jashtme se nuk na japin. Për këtë propozim Malenkovi tha, mirë shikojeni, po keni lëndë të parë? Sidoqoftë shiheni.

Unë bisedova me Kiçon dhe del se mund ta shtyjmë hidrocentralin gjer më 1957, sepse më 1955 do të fillojmë ndërtimin e disa të tjerave. Përsa i përket fabrikës së letrës mendojmë ta bëjmë qoftë dhe më vonë, se për këtë kemi shumë nevojë dhe nxënësit tanë nuk kanë me se të bëjnë provimet. Kur të mbarojnë së ndërtuari këto fabrika atëherë do të mbarojë edhe hidrocentrali që do të na nevojitet për energji. Ata thanë Pravilno edhe për këtë. U thashë gjithashtu se do të shkurtojmë edhe aparatet e rinisë, të sindikatave dhe organizatave të tjera shoqërore.

Pastaj do të ulim edhe investimet që kryhen nga dikasteret e tjera veç e veç, me përjashtim të Ministrisë së Bujqësisë. Beria ndërhyri dhe tha që edhe në bujqësi të bëni shkurtime se edhe atje ka gjëra që nuk është nevoja t'i bëni tani për tani. Unë i thashë t'i fusim bujqësisë kanalizime dhe bonifikime të mëdha, por Beria tha t'u jepni fshatarëve ndihmë konkrete dhe të shpejtë me kanale të vogla që të vadisin sa më shumë toka. Edhe ne, tha ai, kemi lënë shumë ndërtime të mëdha, si p.sh Kanalin e madh të Turkmenisë të cilin e kemi shtyrë për më vonë.

Pastaj u thashë edhe për lënien e hekurudhës. Pravilno, tha Beria, mos bëni asgjë po nuk patët të qartë leverdinë ekonomike. Për impiantin e bitumit, mund ta shohim, u thashë. Por harrova t'i pyesja për aerodromin. Hekurudhën vërtet do ta shtyjmë, i thashë, por për transportimin e qymyrit do të na nevojiten

300 kamionë ZIS. Tani të them mbi nevojat tona që do t'i kërkojmë qeverisë sovjetike. Kur fola për kanalizimet më thanë se kërkesat i shihni më mirë, kur të veni në Shqipëri dhe na i bëni në bazë të orientimit të ri. Ne do t'u ndihmojmë, thanë shokët udhëheqës sovjetikë, portat për ju dhe për kërkesat tuaja do të jenë kurdoherë të hapura për zhvillimin e bujqësisë, të naftës dhe porsa i përket ndryshimit të listave të kërkesave ato mbeten. Për nevojat e Ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u thashë se jam plotësisht dakord me këshillat e shokut Beria për studimin e riorganizimit, po kështu edhe me vërejtjet e shokut Bulganin në lidhje me zgjatjen e afatit të pastrimit që nuk është mirë.

Unë ju thashë se informatat që keni se 30% e oficerëve tanë janë armiq nuk është e saktë se e tillë është situata e vendit tonë. Kompozicioni social i vendit tonë është i tillë që në Shqipëri ka njerëz të shtresave të larta edhe nga ata që i kanë sot prindërit në burg ose me armikun, por që vetë kanë luftuar dhe që sot janë me Partinë. Unë jam dakord të na vinë 250 oficerë për nevojat e ushtrisë, por shtrova se kemi nevojë dhe duam të na vijnë edhe për repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mirë, edhe për këtë jemi dakord, thanë ata. Por përpara se të bisedojmë për këto çështje, shkoni në Shqipëri dhe i studioni mirë këto probleme.

Pastaj u kërkoja edhe armatime, që i aprovuan, por thanë se do ta studionin edhe këtë çështje.

Për politikën e jashtme u thashë se jam dakord për përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjët, se ne do të ecim me prurësi dhe do të këshillohemi me ju kur ta shohim të nevojshme, sepse nuk mund të bëjmë dot asgjë pa u këshilluar me ju; pasi vendi ynë është i vogël dhe me pozita shumë delikate. Përveç shkëmbimit të ministrave me ju do të studiojmë se ku ka mundësi të përmirësohet gjatë situata e vendit tonë.

Në lidhje me marrëdhëniet ekonomike me Italinë, ata thanë, i shihni. Për disa gjëra të vogla që ju i keni kontraktuar me firmat private italiane do të ishte më mirë t'i kontraktoni me qeverinë italiane.

Unë iu thashë se në rast se janë momentet, ne kërkojmë që Shqipëria të lidhë traktate zyrtare miqësie bashkëpunimi dhe ndihme reciproke me BS dhe me qeveritë e vendeve demokratike. Pra këto çështje donte të fliste Beria, por Malenkovi sa dëgjoji propozimin tim tha: Çfarë, çfarë, do ta shohim, vetëm se për këtë çështje mos u vejë si provokacion fqinjëve tuaj.

Ata na këshilluan që Ministria e kontrollit të mos jetë e madhe dhe mbledhjet e qeverisë të jenë të shpeshta dhe për organizimin e aparateve nuk na dërgojnë njeri por ta bëjmë vetë.

Për në krye të Ministrisë së jashtme, Molotovi tha se mund të gjesh vetë ndonjë njeri, por edhe ne mund të të ndihmojmë me ndonjë shok.

Beria më këshilloi që një të tretën e kohës së punës t'ia kushtoj bujqësisë, të interesohem më shumë për këtë sektor. Bujqësia tani është hallka më e rëndësishme për forcimin e ekonomisë tuaj. Prandaj të këshillojmë të marrësh kontakt me fshatarët, të bisedosh me ta për situatën ekonomike e kulturore, të mos vesh me ceremoni dhe në forma zyrtare te fshatarët, por sipas rastit dhe pa e pritur fare ata, të jesh në mes tyre. Kur të shohë partia dhe populli se sekretari i përgjithshëm dhe kryeministri interesohen për fshatin ata do të vdesin për partinë. Bëni doemos përmirësimin e bujqësisë brenda viteve 1953 dhe 1954 në mënyrë që dhjetëvjeçari i çlirimit ta gjejë ndryshe fshatarësinë dhe gjendjen e vendit tuaj krejt ndryshe.

Të merren gjithashtu masa edhe për përmirësimin e gjendjes në qytete. Të mos bëni mbledhje pas mbledhjesh për vënien në jetë të këtij orientimi dhe të merrni vendime duke bërë plot zhurmë, por të bëni punë konkrete dhe shpejt.

T'i jepni mundësi fshatarit të vejë lopë, derra të bëjë bukën dhe të jetë i kënaqur. Të merrni masa që brenda këtyre dy vjetëve të përmirësohet jeta e vendit tuaj, ndryshe do të ndodhë katastrofa. Ju i keni marrë taksa të rënda popullit. Në 200 mijë ton prodhim, t'i marrësh 50 mijë fshatarësisë si taksë në natyrë, kjo është vjedhje. Prandaj t'i merrni më pak detyrime fshatarësisë, na thanë ata, dhe sasinë tjetër që do t'u nevojitet e bleni në treg me një vleftë më të madhe se deri tani. Kjo tregti i intereson fshatarit. Në bujqësi do të luftohet për të marrë rendimente të larta dhe të mos niseni për të bërë ndërtime të mëdha për bujqësinë, por duke punuar më mirë. Bëni kanale të vogla, merrni masa konkrete, të shpejta dhe të frytshme, pa investime të mëdha. U jepni fshatarëve pleh, farë me cilësi të mirë. Çështja është që fshatari të ngrihet ekonomikisht, ta lehtësoni sa më parë nga detyrimet e tatimet e rënda që i keni vënë.

Mikojani dhe Malenkovi më folën për çështjen e kolektivizimit dhe më këshilluan që të mos shpejtohem. Beria më pyeti nëse kishim kolkoze në malësi. Unë i thashë jo. Lerini, tha ai, mos u nxitoni. Ata na thanë edhe njëherë se çështja e kolektivizimit të mos shpejtohet. Bile duhet të ndalohet fare, gjersa të krijohen kondita të favorshme për këtë. Dhe atje ku kooperativat venë keq le të shpërndahen. Po të jetë se ka ndonjë fshatar në kooperativat ekzistuese që dëshiron të dalë nga kooperativa, lereni le të ikë, mos kini frikë. Në krye të Ministrisë bujqësisë thanë ata, duhet të jetë një nga shokët më të mirë; prandaj të forcohet ky sektor me kuadrot më të mirë. Edhe në Komisionin e Planit ai që do të merret me bujqësinë duhet të jetë zëvendësi i Presidentit të Planit. Ne do t'ju dërgojmë shokë kompetentë për bujqësinë që gjatë 1953 dhe 1954 të forcohet bujqësia juaj.

Përsa u përket punëtorëve të minierave, ata thanë se rrogat e tyre duhet të jenë më të madhe se ato të punëtorëve të industrisë. Mos bëni lëvizje të shpeshta kuadri, na thanë, Mos i mobilizoni në ushtri specialistët. Kjo gjë duhet të frenohet. Pastaj ata ngritën çështjen nëse ka mundësi të shtyhet mbarimi i fabrikës së çimentos që të lehtësohet pak situata gjatë këtyre dy viteve.

Në politikën e jashtme duhet të ecet drejt përmirësimit të marrëdhënieve me fqinjët.

Në lidhje me çështjen e ushtrisë, kur u thashë se nga ata 35% që na thatë ju nuk janë të gjithë armiq, se shumica janë oficerë që kanë bërë luftën, Beria me gjithë Malenkovin më thanë se nuk kishim vepruar mirë që kemi nxjerrë nga ushtria dhe nga partia njerëz që kanë pasur diçka në jetën e tyre, që kanë bërë gabime por që janë përmirësuar vonë. Si do ti hidhni jashtë këta njerëz? Në asnjë mënyrë, përsëritën ata. Ju keni bërë edhe gabime të tjera, thanë ata. Ne kemi mbajtur në ushtri dhe në parti njerëz që na kanë luftuar vite me radhë, por për t'i bërë ata me ne, kemi nxjerrë dekrete speciale dhe ua kemi falur të kaluarën e keqe; por tani janë adaptuar dhe mbajnë një qëndrim të vendosur me ne, dhe ne nuk i hedhim poshtë. Nga ushtria duhen përjashtuar vetëm ata që kanë të kaluar të keqe dhe qëndrim aktual të keq.

Me gjithë këtë edhe këta mund të mbeten oficerë rezervë dhe të vihen menjëherë në punë. Përjashtimi i oficerëve nga partia për arsye se kanë qenë me armikun, por më vonë janë hedhur me ne dhe tani duan të punojnë me ne, nuk duhet të jetë shkak të hiqen dhe nga ushtria. Njerëzit pastaj nuk lindin komunistë, kanë në jetën e tyre gabime, lëshime dhe të meta. Të tilla gabime këtyre njerëzve t'u vihen në dukje zyrtarisht, të ndreqen dhe dashuria e tyre për partinë të matet me punën dhe me qëndrimin e tyre. Ju nuk duhet të keni frikë t'u falni të kaluarën këtyre njerëzve. Kjo ka qenë dhe është vija tonë, tha Malenkovi. Ne kemi në ushtri njerëz që na kanë luftuar dhe për këtë kemi bërë ligje të veçanta për falje. Kështu u japim mundësi njerëzve të punojnë dhe të qëndrojnë në radhët e ushtrisë. Ata që janë me ne të rishikohen dhe të mbeten në Parti. Për ata që janë në shqyrtim të veproni drejt. Të bëhet një komision dhe të vinë në Parti njerëz që janë kthyer e janë me ne.

Më në fund Malenkovi më tha të filloni dhe t'i bëni në mënyrë aktive këto gjëra, pa shikuar gjatë. Në rast se nuk do të keni ndonjë gjë të qartë, na pyesni dhe ne do t'u përgjigjemi.

Pastaj më pyeti se si shkomë me klerin dhe ia tregova situatën dhe qëndrimin tonë.

Ja këtu pakeni gabuar, më tha Beria, lerini hoxhallarët të bërtasin. Të gjitha këto i studioni, i konkretizoni. Kërkesat tuaja na i dërgoni dhe ne do t'i studiojmë. Ne jemi plotësisht të bindur se duke vepruar kështu punët tuaja do të shkojnë mirë.

Unë mendoj se orientimi që na dhanë shokët e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik është një ndihmë shumë e çmueshme dhe duhet ta vëmë sa më parë në jetë. Për këtë gjë duhet të rishikojmë të gjithë punën tonë dhe në radhë të parë problemin e lehtësimit të fshatarësisë. Por çështjet janë të lidhura me njëra tjetrën, prandaj nuk mund të lëmë pa bërë njëkohësisht edhe shkurtimet në aparatën e shtetit. Për këtë them se çështja kryesore që na vihet

përpara është që të krijojmë sa më parë komisionet. Por para se të bëjmë këtë duhet të biem dakord me këtë platformë, domethënë:

Për shkurtimin e aparateve qendrore, minimumi 50%;

Për shkurtimin e aparateve të komiteteve të partisë dhe ekzekutive;

Për riorganizimin e pushtetit në qarqe.

Për të bërë këtë punë duhet të krijojmë komisione. Për aparatet qendror dhe të pushtetit mund të krijojmë një komision të veçantë që të ketë parasysh dhe krijimin e qarqeve, shtimin e disa rretheve etj. Këto gjëra duhen studiuar pak.

Krahas me këtë të formohet një komision tjetër që porsa të mbarojë punën i pari, ky ta ketë zgjedhur kuadrin në bazë të organizimit të ri, domethënë të interesohet për plotësimin e organikës me kuadro se me këtë rast do të bëhet këtu një lëvizje e madhe.

Një komision tjetër duhet të punojë këtu për rishikimin e planit në lidhje me heqjen e investimeve të mëdha dhe të krahut të punës.

Pastaj duhet edhe një komision për çështjen e rishikimit të të gjitha urdhëresave që kanë lidhje me lehtësimin e fshatarësisë nga detyrimet në natyrë, nga taksat etj.

Domethënë të bëjmë gjithsej 4 komisione, të cilëve t'u caktojmë edhe afatet për punën që do t'u ngarkohen. Të kihet parasysh që puna e këtyre komisioneve të mbahet shumë sekrete.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Unë mendoj të jenë dy komisione. I pari për atë që thatë ju, domethënë për të marrë në shqyrtim shkurtimin e organikave dhe thjeshtëzimin e organeve të pushtetit në rrethe, me një fjalë çështjen e pushtetit, të riorganizimit dhe të organikave. Ky komision ka mundësi t'i bëjë këto. Çështjet parimore kryesore do t'i vendosim ne, pastaj për masat konkrete do të vendosë qeveria. Komisioni tjetër është për rishikimin e politikës së tatimeve në drejtim të fshatarësisë. Përsa i përket planit duhet të interesohet komisioni i Planit dhe për çështjet e kuadrit aparatet përkatëse të Komitetit Qendror të partisë. Kuadrot kryesore ne i njohim dhe do t'i vendosim vetë këtu.

*Shoku Enver Hoxha:*

Unë them të ketë një komision edhe për çështjen e kuadrit se ai do të bëjë më shpejt punën për vendosjen e kuadrit kryesor, pa u futur në biografite se ne i njohim njerëzit. Këtu vetë ne duhet të shohim ministrat dhe sekretaret e rretheve. Për këta nuk është nevoja të na vinë biografite se i njohim. Me gjithë këtë e shohim më vonë çështjen.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Për këtë çështje, sikur edhe ju me ndonjë nga ne të ngarkohet mund të paraqesë një studim në Byro. Ju me ndonjë nga ne jeni në gjendje ta bëni këtë

gjë. Të dy komisionet duhet të punojnë shumë se çështjet që do të studiojmë kanë shumë rëndësi, si nga ana ekonomike ashtu dhe nga ana politike.

*Shoku Enver Hoxha:*

Këto dy komisione në punën e tyre të kenë parasysh dhe të bëjnë llogari mirë organikat lidhur me çështjet ekonomike. Të llogaritet mirë çështja e bukës dhe e detyrimeve. Pastaj ti Mehmet duhet të punosh vetë për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Propozoj që të studioni dhe çështjen e policisë së lokalitetit, kemi ne interes ta mbajmë këtë polici, apo në vendin e saj të vemë një polici me rrogë që të bëjë detyrën e korrierit? Mirëpo prapë këta njerëz do t'i hiqnim nga fshati, do t'i largonim nga bujqësia, prandaj ta shohim. Shikoni mirë dhe policinë e stabilimenteve.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Dakord jam, do ta shohim.

*Shoku Enver Hoxha:*

Edhe ushtria mund të bëjë disa spastrime. Pastaj për këto gjëra ne duhet të marrim një vendim. Për këtë platformë do të caktojmë sa ministri do të kemi, 8 apo 9. Pastaj Byroja Politike të interesohet për njerëzit kryesorë. Për çështjet kryesore duhet të marrim vendime në parim, p.sh që hidrocentralin, rafinerinë etj. t'i shtyjmë. Prandaj duhet të llogarisni se gjer kur duhet t'i shtyjmë. Këto të studiohen mirë se janë gjëra që lidhen me kuadrin, me krahun e punës etj. Pastaj duhet të vendosim edhe për çështjen e Beqirit. Unë mendoj se ai duhet të vijë, ndryshe mbetemi formalë në vendimet që do të marrim se do të okupohemi unë dhe Mehmeti me çështjen e ushtrisë gjersa të kthehet Beqiri.

*Shoku Mehmet Shehu:* Ajo e ushtrisë të bëhet siç thoni ju, domethënë Ministër i mbrojtjes të bëhet të bëhet Beqiri dhe ju të mbeteni Komandant i Përgjithshëm, bile për ta zbutur opinionin e jashtëm, shokut Enver t'i themi Kryeministër dhe jo Komandant i Përgjithshëm dhe të mos kemi emër Ministër Luftë, kështu e kanë edhe në BS. Çështja e mbrojtjes është në radhë të parë krahas me atë të fshatarësisë, është një preokupacion i madh për ne, për të përballuar me sukses një situatë lufte, është çështja e përgatitjes së kombit për në një rast lufte. Këtu ne do të shohim edhe planin operativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes. Mund të merret një vendim që në vendin tonë të krijohet një këshill i Mbrojtjes i drejtuar nga shoku Enver dhe me anëtar unë dhe Beqiri. Ky vendim të jetë shumë sekret dhe të ruhet në arkivat e Byrosë Politike se këto janë probleme shumë të rëndësishme dhe nuk mund të mbeten pa u studiuar.

*Shoku Enver Hoxha:*

Për këtë çështje të pyesim njëherë. Edhe në Ministrinë e jashtme duhet të vemë një njeri.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Unë kam menduar edhe për njerinë. Le të thërasim këtu Lirinë, të shkojë Manushi në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Mihal Prifti të vejë në Romë në vendin e Behar Shtyllës i cili mendoj të bëhet ndihmës ministër.

*Shoku Enver Hoxha:*

Unë them të mos e heqim Lirinë andej, le të mbarojë shkollën. Behari është njeri i zoti, sikur të bëjmë një tjetër ministër, duhet të gjejmë një njeri që të jetë më i lartë nga Behari në rast se ky do të bëhet ndihmës, më i lartë si nga ana e Partisë ashtu edhe e kulturës. Nga shokët e Komitetit Qendror mendoj se Fadili është i përshtatshëm për atë vend se është njeri me kulturë dhe anëtar i KQ. Megjithatë po të vendosim për Beharin, edhe ai e bën këtë detyrë dhe është njeri besnik.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ahere do ta mbani ju në lidhje si kryeministër.

*Shoku Enver Hoxha:*

Ministri i jashtëm duhet ta kuptojë mirë vijën dhe të veprojë dhe jo të vejë e të pyesë edhe për gjërat më të vogla, siç bën Mihal Prifti.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Kur është çështje notash, ai duhet të marrë patjetër të paktën pëlqimin e kryeministrit ose të qeverisë. Sidoqoftë Behari e bën 100 herë më mirë këtë punë nga Mihali.

*Shoku Enver Hoxha:*

Ahere këto t'i vendosim dhe t'i vihemi punës. Prandaj sot edhe nesër është mirë të reflektojmë për këto çështje dhe të hënën në mëngjes të vimë këtu me propozime konkrete për komisionet. Në komisionin e parë mendoj të jesh ti Mehmet në krye. Për të tjerët e shohim më vonë. Hysniu të shohë mirë dhe konkretisht çështjen e bujqësisë dhe Spirua atë të planit.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Spirua të merret direkt me planin se ç'shkurtime do të bëhen.

*Shoku Enver Hoxha:*

Komisioni i Planit të studiojë rishqyrtimin e urdhëresave dhe çështjet ekonomike. Në komisionin e parë të jenë edhe Dyl Këllezi, Tuku dhe Qirjako Haritua.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Këtë përbërje duhet ta shohim, se Tuku është i ngadalshëm dhe do të na i bëjë hiqe e mos e këput si punën e kategorizimit.

*Shoku Manush Myftiu:*

Dhe ne duhet të jemi në këtë Komisionse duhet të paraqesim dhe ne propozimet për shkurtrimin e organikave dhe aparateve të partisë.

*Shoku Mehmet Shehu:*

A nuk do të bëjmë ndonjë mbledhje plenumi për këtë çështje?

*Shoku Enver Hoxha:*

Komitetin Qendror, qeverinë, dhe Presidiumin e Kuvendit Popullor t'i mbledhim kur t'i bëjmë të tëra gati, ashtu na thanë edhe shokët sovjetikë. Vetëm se këto punime duhet të jenë shumë sekrete. Ju që do të mbledhni komisionet t'u thoni bashkëpunëtorëve tuaj se çdo fjalë që të dalë nga ana e tyre dhe menjëherë pushkatim, se po të marrin vesh njerëzit që do të bëhen gjithë këto ndryshime do të krijohet një ankth i madh në ta, jo ku do të jem unë, jo ku do të jesh ti. Pastaj ministrat duhet të kenë kompetenca më të mëdha dhe të kenë lidhje direkte me kryeministrin, të bashkëpunojnë, por sigurisht jo për gjëra të vogla.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Në rast se do të udhëhiqemi nga parimi që çdo nënkryeministër të mbajë lidhje me ministrat, nuk mjaftojnë dy nënkryeministra. Në rast se do të jenë vetëm nënkryeministra dhe ministra në sektorët e tyre, ahëre mjaft janë dy nënkryeministra.

*Shoku Enver Hoxha:*

Ne duhet të likuoidojmë të gjithë aparatën e Kryeministrisë, por atje duhet të krijohet një aparat për mua. Komisioni i Planit do të shkurtohet gjysëm për gjysëm, duke u formuar nga një degë për çdo ministri të re. Kështu organikat do të përgjysmohen. Perspektiva të mëdha do të na hapen në këtë mënyrë, por duhet punuar në mënyrë të prerë. Tani ta lemë mbledhjen e KQ, të marrim të gjithë këto vendime dhe pastaj t'i shtrojmë atje për aprovim kur të kemi bërë çdo gjë gati.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ky duhet të jetë plenumi më i afërt që do të bëhet për këto çështje dhe konsumon të dy plenumet e kësaj kohe që kishim parashikuar në plan, domethënë atë për çështjen e kuadrit dhe atë që do të paraqisja unë për çështjen e pushtetit.

*Shoku Enver Hoxha:*

Tani hapen gjithë këto perspektiva të reja, në radhë të parë përgatitja e planit është përgatitja e të gjithë këtyre gjërave që do të bëjmë. Ka disa gjëra që duhet të bëjmë, p.sh masat për përmirësimin e gjendjes së fshatarësisë. Këto ne mund t'i bëjmë që përpara plenumit. Sa më shpejt të bëhen këto aq më mirë është, se shpëtojmë shumë të holla dhe përmirësohet edhe furnizimi i popullit.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ka të ngjarë t'i bëjmë për një muaj domethënë t'i bëjmë brenda korrikut?

*Shoku Spiro Koleka:*

Lehtësime fshatarësisë mund t'i bëhen edhe pa marrë fund akoma këto vendime që u diskutuan këtu.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ne duhet t'i bëjmë mirë llogaritë, të shohim nevojat e fshatarësisë dhe ato të shtetit. Pa bërë si duhet këto llogari nuk mund të marrim asnjë vendim.

*Shoku Enver Hoxha:*

Po edhe shumë shpejt nuk mund t'i bëjmë këto gjëra se duan studime, p.sh brenda një muaji s'i bëjmë dot.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ne duhet të caktojmë edhe metodën se çfarë do të paraqesim në Byronë Politike dhe kur.

*Shoku Enver Hoxha:*

Shokët sovjetikë thanë se këto punë që do të bëjnë komisionet përpara se të merrnin vendime duhet t'i kontrolloni si po ecin. Duhet parë me kujdes çështja e burokracisë jashtëzakonisht të madhe, sidomos me dokumentet që kanë të bëjnë me fshatarësinë.

### **PROTOKOLL NR. 18**

#### **më 22 qershor 1953 i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ PPSH**

##### **Rendi i ditës:**

Mbi marrjen e masave konkrete për të vënë në jetë orientimin e ri në çështjet ekonomike dhe shtetërore sipas ndihmës së dhënë nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik.

##### **Zhvillimi i Mbledhjes:**

.....

*Shoku Enver Hoxha.*

Në Komitetin Qendror ne do të themi se kemi bërë gabime të mëdha, por të fillojmë të bëjmë tani prapë autokritikë?

*Shoku Hysni Kapo:*

Të mos bëjmë vetëm autokritikë po të themi edhe gabimet tona qoftë kolektive si udhëheqje, ose individuale. Ja psh, unë kam gabimet e mia personale në lidhje me fshatarësinë, prandaj mendoj se në KQ, si Byro, duhet të dalim me një analizë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Analiza kryesore duhet të jetë kjo dhe të mos futemi në hollësira e diskusione të kota. Ne njohim faktin se në lidhje me jetën e vendit dhe të popullit tonë kemi gabuar dhe na imponohet urgjentisht të marrim masa për ta ndrequr situatën. Po të hyjmë dhe të bëjmë analiza dhe referate dhe të analizojmë gjendjen do të vemi larg.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Këtu jemi përpara një rishikimi politik të çështjeve të fshatarësisë dhe të bëhet një punë e tillë e përciptë në Komitetin Qendror, pa analizuar mirë përgjegjësitë tona kolektive si Byro Politike, si sekretariat, si qeveri përpara Komitetit Qendror, nuk është e drejtë. Ne duhet të tërheqim konkluzione për këto gabime dhe pastaj të dalim përpara Komitetit Qendror. Ne duhet të dalim me një referat të shëndoshë, prandaj mendoj se duhet t'i shqyrtojmë më parë këto gjëra në Byro, por sigurisht pasi të mbarojnë të gjitha këto përgatitje. Tani ne vijën e kemi dhe jemi të sigurt se është e drejtë, do të punojmë për të realizuar në jetë këtë vijë dhe kur të jemi në gjendje do ta paraqesim çështjen në KQ.

*Shoku Enver Hoxha:*

Unë nuk jam i mendimit t'i dalim Komitetit Qendror me këto gjëra. Të kemi ne pretendime të bëjmë një analizë të thellë, mendimi im është se nuk e bëjmë dot. Prandaj edhe këtë analizë do ta bëjmë sikundër kemi bërë ato të tjerat deri tani. Analizë të thellë unë them të mos bëjmë dhe të merremi me shifra se do të na shkojë shumë gjatë. Të mos dalim me analizën e situatës së fshatarësisë se kjo është një punë shumë e madhe.

*Shoku Hysni Kapo:*

Juve në BS ju thanë që të bisedoni edhe më shokët. Këtë unë e kuptova që të bëjmë një analizë mbi të metat dhe gabimet tona se në fakt këto gabime janë të mëdha dhe nga ato duhet të nxjerrim mësim. Unë jam dakord me orientimin; por ky orientim duhet të zbatohet mirë, nëpërmes një analize, se ne si udhëheqje do të dalim përpara KQ dhe këtë do ta bëjmë pa e penguar punën që po vendosim këtu.

*Shoku Enver Hoxha:*

Unë këtë nuk po e kuptoj. Si e kupton ti ta bëjmë këtë analizë?

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ashtu sikurse kemi bërë të gjitha analizat e tjera me mundësitë dhe kapacitetin tonë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Ne kemi bërë dhe analizën e plenumit X dhe me gjithë këtë ecëm në këtë rrugë të gabuar. Kur bëjmë atë analizë, nxorëm p.sh se sa i kushton jetesa fshatarësisë. Atëherë përse erdhëm deri në këtë pikë?

*Shoku Mehmet Shehu:*

Se nuk kemi vepruar drejt.

*Shoku Enver Hoxha:*

Po të bëjmë një analizë shkencore Marksiste-Leniniste të situatës do të jetë e zorshme për ne. Këtë punë nga ana parimore do ta bëjmë, por një analizë të thellë për situatën e fshatarësisë që do të ishte një gjë shumë e mirë do të jetë e zorshme, pse ku do të bazohesh që ta bësh, se ne kemi dy vjet që po studiojmë këtë çështje dhe nuk kemi bërë asgjë dhe këtu ne kemi gabuar.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Fakti është se këto gjëra janë analizuar nga lart, por ne si Byro Politike ç'kemi bërë nga ana tonë? Ne kemi përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe se sikur të mos na sinjalizonin ata, kjo ishte rruga e greminës për ne. Pra, të mos analizojmë në Komitetin Qendror gabimet tona, më duket diçka e padrejtë. Ne duhet të dalim me një raport përpara plenumit dhe me një autokritikë të shëndoshë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Të kuptohemi pak më mirë. Unë nuk jam në kundërshtim që të mos dalim me një analizë për gabimet tona të mëdha, por një analizë të thellë Marksiste-Leniniste nuk e bëjmë dot se nuk kemi mundësi ta bëjmë.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Ta bëjmë ashtu sipas kapacitetit tonë.

*Shoku Hysni Kapo:*

Ne i aprovuam plotësisht këshillat e shokëve udhëheqës sovjetikë, këto gjëra tani do t'ia çojmë qeverisë dhe atje do të vendosim masat paraprake që do të marrim. Edhe unë mendoj se përpara Komitetit Qendror ne duhet të dalim me një autokritikë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Kjo është e natyrshme.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Sikur të mos na kishin sinjalizuar nga lart dhe kjo gjë të ishte zbuluar në Byronë Politike tonën, dmomethënë ne në Byro të kishim arritur në këto konkluzione, nuk do të guxonim ta shtronim çështjen për marrjen e masave praktike në qeveri pa e shqyrtuar më parë çështjen në Komitetin Qendror. Tani me qenë se jemi të sigurt nga këshillat e shokëve sovjetikë, vemi drejtpërsëdrejti në qeveri me këto masa.

*Shoku Enver Hoxha:*

Unë nuk jam i mendimit të bëjmë një analizë të thellë të çështjes së fshatarësisë, por që duhet të dalim përpara KQ me autokritikë si Byro dhe si qeveri dhe të themi se kemi bërë këto dhe këto gabime, kjo është e domosdoshme, nuk mund të vihet në diskutim se ne kemi luajtur me kolektivizimin dhe megjithëse unë nuk kam qenë dakord, prapë jemi shpejtuar. Për çështjen e detyrimeve të fshatarësisë kemi dalë me konkluzione se është rënduar dhe kësaj çështjeje prapë i kemi bërë bisht. Këto gjëra ne do t'i themi. Unë këtu e kisha, nëse mund të bënim dot një analizë të hollësishme dhe mendoj se nuk e bëjmë dot.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Analiza e plenumit X është nisur nga çështjet praktike konkrete të fshatarësisë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Ajo ka pasur një vlerë po nuk kemi nxjerrë konkluzione dhe ato t'i kthenim pastaj në vendime si na i shtruan ata. Vendimet që kemi marrë për bujqësinë janë shumë të drejta, por në rast se edhe tani nuk i zbatojmë, prapë do të ecim ashtu sikurse bëmë pas plenumit X<sup>të</sup>.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Pse mbeti pa vlerë plenumi X<sup>të</sup>? Janë bërë ca përparaime, por është politika e madhe ajo që na pengoi. Partia ka punuar për plenumin e X<sup>të</sup>. Kur i kemi analizuar këto çështje në Byronë Politike, kemi thënë se po i marrim fshatarit më shumë nga ç'i merrnim përpara sistemit të ri të grumbullimit, por mbetëm vetëm në konstatimet, nuk u thelluam dhe vazhduam t'i merrnim fshatarit gjithnjë e më shumë.

*Shoku Enver Hoxha:*

Gabimet tona jo vetëm do t'i shtrojmë në KQ, por mendoj që edhe rezolucioni të shtypet në gazetë që të marrë vesh edhe populli se si ka punuar partia. Të thuhet atje se ne kemi bërë gabime këtu dhe këtu.

*Shoku Mehmet Shehu:*

Masat që do të marrim do ta forcojnë pozitën e partisë, të Byrosë Politike dhe të KQ. Prandaj të studiojmë mirë këtë çështje dhe të vemi mend, se e kemi jetuar këtë situatë dhe e kemi parë si spektatorë. Pra, herë tjetër të mos na ndodhin të tilla gjëra, të kemi mendjen dhe të studiojmë më thellë se të gjitha mundësitë i kishim që të mos binim në këto gabime.

### **Mbi korrjimin e disa gabimeve në politikën ekonomike sidomos në drejtim të fshatarësisë dhe për forcimin e gjendjes së brendshme**

Byroja Politike e KQ të PPSH, në mbledhjen e saj të dt 20 dhe 22 qershor 1953, dëgjoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të partisë, shokut Enver Hoxha, mbi bisedimet që pati në Moskë me udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të shtetit sovjetik, në gjysmën e parë të muajit qershor të këtij viti.

Byroja Politike e Komitetit Qendror i konsideron shumë të drejta konstatimet e shokëve udhëheqës sovjetikë për të përmirësuar gjendjen e vështirë ekonomike të popullit tonë dhe i konsideron ato këshilla si një ndihmë tjetër jashtëzakonisht të madhe dhe shpëtimtare për popullin, partinë dhe Republikën tonë Popullore.

Ku konsistojnë gabimet e partisë sonë të vëna në dukje nga shokët udhëheqës sovjetikë:

#### **I - NË POLITIKËN E BRENDSHME:**

##### **A. Në çështjet ekonomike:**

1) Duke e ngarkuar fshatarësinë punonjëse të vendit tonë me detyrime dhe tatime të rënda, jashtë fuqisë së saj.

2) Duke zgjeruar jashtë forcave dhe kapacitetit tonë ndërtimet e objekteve industriale, pa llogaritur mirë leverdinë e tyre ekonomike dhe në disa raste pa qenë shumë e nevojshme ngritja e disa prej tyre për këtë fazë të zhvillimit të ekonomisë sonë popullore. Një praktikë e tillë ka dobësuar bujqësinë, furnizimin e popullit dhe ka shkaktuar inflacionin.

##### **B. Në çështje të organizimit të aparatit shtetëror:**

Duke zgjeruar shumë aparatit burokratik të shtetit dhe të organizatave ekonomike dhe shoqërore, duke i bërë këto aparate shumë të kushtueshme, gjë që ka vështirësuar shumë gjendjen ekonomike të punonjësve dhe kryesisht të fshatarësisë.

##### **C. Në çështjet e organizimit të ushtrisë:**

Duke mos marrë masa të mjaftueshme për forcimin e mëtejshëm dhe pastrimin e radhëve të ushtrisë sonë popullore.

#### **II - NË POLITIKËN E JASHTME:**

Duke ekskluduar përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve të vendit tonë me jashtë, sidomos me shtetet fqinje, Itali, jugosllavi dhe Greqi.

Për të përmirësuar gjendjen e brendshme dhe të jashtme të vendit tonë, byroja Politike e KQ, duke pasur kurdoherë parasysh këshillat shumë të çmueshme dhe ndihmën shpëtimtare të shokëve udhëheqës të Partisë Komuniste dhe të qeverisë së BS, vendosi:

**I - Për përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit tonë dhe në radhë të parë të fshatarësisë punonjëse:**

1 - Të ngarkohet Qeveria e Republikës të fillojë menjëherë studimin e masave konkrete në drejtim të përmirësimit të gjendjes ekonomike të fshatarësisë. për këtë qëllim të veprohet si më poshtë:

- a) Brenda dy ditëve të urdhërohet dhe të shpallet falja e të gjitha detyrimeve të prapambetura nga vitet 1949, 1950, 1951, dhe 1952 në drithëra, mish, vezë, fasule, oriz etj.
- b) Gjer në 5 korrik 1953 të ketë përfunduar studimi për uljen e detyrimeve të të gjithë artikujve bujqësorë dhe blegtoralë, sidomos për zonat kufitare dhe malore.
- c) Këshilli i Ministrave dhe veçanërisht Ministria e Bujqësisë, të marrin masa konkrete për përmirësimin e bujqësisë me ndërtim veprash të vogla por që i sjellin rezultate imediate fshatarësisë për shtimin e prodhimeve si ndërtim kanalesh etj. Si dhe ndihmë në fara, vegla pune, kafshë etj. Të evitohen në këtë fazë investimet e kushtueshme në bujqësi dhe që duan një kohë të gjatë për t'u realizuar.
- ç) Të kihet parasysh që në drejtim të kolektivizimit të forcohen kooperativat bujqësore ekzistuese dhe të mos ecet me hapa të shpejtuara në këtë drejtim, bile në këtë fazë të ndalohet përkohësisht ngritja e kooperativave të reja bujqësore gjersa të krijohen konditat e favorshme për realizimin e këtij objekti të rëndësishëm siç është ndërtimi i socializmit në fshatin tonë.

2. Të merren masa për rishqyrtimin e ligjeve, urdhëresave e dispozitave të tjera financiare për të lehtësuar tatimet në drejtim të fshatarësisë dhe të prodhuesve të vegjël të qytetit.

Të merren masa për ristudimin e rrogave të punëtorëve dhe nëpunësve të vendit tonë duke pasur parasysh që rrogat e punëtorëve të naftës veçanërisht dhe në përgjithësi të punëtorëve të tjerë të minierave të jenë më të mëdha në krahasim me ato të punëtorëve të industrisë dhe sektorëve të tjerë.

3. Për realizimin e detyrave të mësipërme të formohet një komision nën kryesinë e shokut Gogo Nushi dhe me pjesëmarrjen e shokut Hysni Kapo për të marrë sa më parë në studim masat për përmirësimin e gjendjes ekonomike të popullit, sidomos të fshatarësisë punonjëse.

4. Të shqyrtohet gjer më 15 korrik 1953 plani i investimeve për heqjen e disa objekteve të pesëvjeçarit të parë 1951-1955, që nuk janë të nevojshme për t'u ngritur dhe të merren masa të menjëhershme për shkurtimin e krahut të punës. Të shtyhet afati i mbarimit të hidrocentralit "Enver" nga 1955 në 1957 dhe i rafinerisë së naftës nga 1954 në 1955.

**Për këtë qëllim Komisioni i Planit të Shtetit, nën drejtimin e shokut Spiro Koleka të rishikojë planin e investimeve dhe t'i propozojë Byrosë Politike objektet e tjera që do të hiqen nga pesëvjeçari i parë 1951-1955, ose që do të shtyhen për më vonë.**

## II - Për riorganizimin e aparatit shtetëror:

1. Të merren masa për shkurtimin e organikave të aparateve administrative dhe ekonomike jo më pak nga 50% nga efekti ekzistues dhe të zbritet numri i dikastereve nga 18 që janë sot në 6 gjer më 9.

Të suprimohet Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe numri i nënkryeministrave të reduktohet nga 6 në 2.

2. Të shkrihen në dikasteret përkatëse të gjitha drejtoritë dhe ndërmarrjet qendrore që kanë afinitet midis tyre. Të rigrupohen të gjitha ndërmarrjet e tjera sipas afinitetit me njëra tjetrën, duke pasur parasysh që ngritja e organizmave të reja të bëhet me organika sa më të shkurtra.

3. Të riorganizohen rrethet në bazë qarqesh, numri i të cilave të mos jetë më i madh se 10 ose 11 dhe njëkohësisht të merren masa për shkurtimin e organikave të pushtetit lokal.

4. Të shkurtohen jo më pak se 50% efektivi i Aparatit të KQ të PPSH, të komiteteve të partisë në rrethe dhe të aparateve qendrore e lokale të organizatave të masave.

5. Të formohet një komision qeveritar, nën kryesinë e shokut Mehmet Shehu për të studiuar shkurtimet e nevojshme të organikave shtetërore, ekonomike dhe të organizatave shoqërore. Për këtë qëllim të ngrihen katër nënkomisione për të studiuar secili shkurtimet e organikave:

- a. Të aparateve qendrore të shtetit;
- b. Të aparateve ekonomike;
- c. Të aparateve të pushtetit lokal dhe
- ç. Të aparateve të partisë dhe të organizatave të masave.

Këto nënkomisione të kenë përfunduar studimin e kontingjenteve të reja dhe t'ia paraqesin për aprovim Byrosë Politike, jo më vonë se më 8 korrik 1953. Në bazë të kontingjenteve të aprovuara, komisioni do të hartojë organikat e reja të organeve shtetërore dhe shoqërore, të cilat do t'ia paraqesë për aprovim Byrosë Politike, jo më vonë se në 1 gusht të këtij viti. Që nga kjo datë dhe gjer

më 1 tetor 1953 duhet të merren masa për vendosjen e kuadrove në bazë të organikave të reja.

### **III - Për forcimin e organeve të Ushtrisë Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme:**

1. Të merret në studim riorganizimi i reparteve të Ushtrisë Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke ia përshtatur këtë riorganizim konditave të vendit tonë për t'i bërë ato më të manovrueshme.

2. Të spastrohen radhët e ushtrisë sonë nga elementët e padëshirueshëm në një afat më të shkurtër nga sa është parashikuar dhe t'i bëhet një kërkesë qeverisë sovjetike për të na dërguar një numër oficerësh për forcimin e mëtejshëm të ushtrisë sonë dhe të aparateve e reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

3. Të rishikohet edhe një herë më mirë gjendja e oficerëve të përjashtuar nga ushtria. Kolegjiumi i KQ PPSH të marrë masa për të studiuar dhe për t'i paraqitur Sekretarit të KQ propozimet për rikthimin në parti të oficerëve që megjithëse kanë gabuar në të kaluarën, por më vonë i kanë korrigjuar gabimet e tyre dhe tani japin prova se duan të ecin në rrugën e partisë.

### **IV. Në drejtimin e politikës së jashtme:**

Të ecet drejt kombinimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit tonë dhe në radhë të parë me shtetet fqinje Itali, Jugosllavi dhe Greqi.

Mbasi të përgatiten të gjitha këto studime, t'i paraqiten për aprovim mbledhjes plenare të KQ të PPSH në Plenumin më të afërm dhe jo më vonë se dt. 31 gusht 1953.

**Me autorizim të Byrosë Politike  
Sekretari i Përgjithshëm i PPSH**

**Enver Hoxha**

